# Albert Kolaj

**person fizik**

# Pasqyrat Financiare

**në datë 31 Dhjetor 2017**

# Tabela e përmbajtjes

**Pasqyra e performancës** ........................ 2

**Pasqyra e pozicionit financiar** ................ 3

**Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare** ..... 4

**Politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare** ..... 5

*1. Informacion i përgjithshëm* ..... 5

*2. Baza e përgatitjes dhe politikat kontabël* ..... 5

2.1. Bazat e matjeve ..... 5
2.2. Njohja e të ardhurave ..... 5
2.3. Veprimet në monedhë të huaj ..... 5
2.4. Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera ..... 5
2.5. Inventari ..... 5
2.6. Aktivet materiale ..... 6
2.7. Titujt e huamarrjes ..... 6
2.8. Llogaritë e pagueshme tregtare ..... 6
2.9. Tatimi mbi të ardhurat ..... 6

*3. Shitje punime e shërbime* ..... 6

*4. Shpenzime të personelit* ..... 6

*5. Shpenzime të tjera shfrytëzimi* ..... 7

*6. Fitimi neto i periudhës* ..... 7

6.1. Shpenzime të pazbritshme ..... 7

*7. Mjetet monetare* ..... 8

*8. Llogari të arkëtueshme* ..... 8

*9. Inventarët* ..... 8

*10. Aktive materiale* ..... 9

*11. Titujt e huamarrjes* ..... 9

*12. Llogari të pagueshme* ..... 9

*13. Detyrime tatimore* ..... 10

13.1. Tatimi mbi fitimin ..... 10

*14. Miratimi i pasqyrave financiare* ..... 10

# Albert Kolaj Person fizik

## Pasqyra e performancës
## për vitin që mbyllet në datë 31.Dhjetor.2017

| | Shënime | Për vitin e mbyllur në 31.Dhjetor.2017 (Lekë) | Për vitin e mbyllur në 31.Dhjetor.2016 (Lekë) |
|---|---|---|---|
| **i. Të ardhura** | | | |
| Shitje punime e shërbime | 3 | 10,062,730 | 3,682,326 |
| **Total të ardhura (i)** | | **10,062,730** | **3,682,326** |
| **ii. Shpenzime** | | | |
| Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme | 9 | -7,003,001 | -1,532,263 |
| Shpenzime të personelit | 4 | -1,201,958 | -1,144,131 |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | 10 | -174,009 | -145,119 |
| Shpenzime të tjera shfrytëzimi | 5 | -173,934 | -96,888 |
| **Total shpenzime (ii)** | | **-8,552,902** | **-2,918,401** |
| **Rezultati nga veprimtaria kryesore (i - ii)** | | **1,509,828** | **763,925** |
| **iii. Shpenzime financiare** | | | |
| Shpenzime financiare | | -204 | -11,384 |
| **Total shpenzime financiare (iii)** | | **-204** | **-11,384** |
| **Rezultati para tatimit ( i - ii +/- iii)** | | **1,509,623** | **752,541** |
| iv. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin | | -238,611 | -51,563 |
| **Rezultati neto i periudhës ( i - ii +/- iii)** | 6 | **1,271,012** | **700,978** |
| *Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:* | | 0 | 0 |
| **Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin** | | **1,271,012** | **700,978** |

ANDI HAXHILLARI

**Andi Haxhillari**
Kontabilist

AlProfit Consult
Andi Haxhillari • L72008007D
Konsulencë Financiare

Albert Kolaj

**Albert Kolaj**
Person fizik

Shërbime Elektrike
ALBERT KOLAJ
TIRANË ALBANIA

# Albert Kolaj Person fizik

## Pasqyra e pozicionit financiar
## në datë 31.Dhjetor.2017

| | Shënime | Në datë 31.Dhjetor.2017 (Lekë) | Në datë 31.Dhjetor.2016 (Lekë) |
|---|---|---|---|
| **AKTIVE** | | | |
| **i. Aktivet Afatshkurtra** | | | |
| Mjetet monetare | 7 | 71,741 | 312,035 |
| Llogari të arkëtueshme | 8 | 14,161,874 | 13,251,648 |
| Parapagime tatimore | | 0 | 189,264 |
| Inventarët | 9 | 94,673 | 595,388 |
| **Total Aktive afatshkurtra (i)** | | **14,328,288** | **14,348,335** |
| | | | |
| **ii. Aktivet Afatgjata** | | | |
| Aktive materiale | 10 | 999,573 | 640,692 |
| **Total aktive afatgjata (ii)** | | **999,573** | **640,692** |
| **TOTAL AKTIVE (i+ii)** | | **15,327,861** | **14,989,027** |
| | | | |
| **DETYRIME DHE KAPITALI** | | | |
| **i. Detyrimet Afatshkurtra** | | | |
| Titujt e huamarrjes | 11 | 11,097,779 | 12,227,779 |
| Llogari të pagueshme | 12 | 958,836 | 792,942 |
| Detyrime ndaj punonjësve | 4 | 494,178 | 509,683 |
| Detyrime tatimore | 13 | 190,056 | 142,623 |
| **Total detyrime afatshkurtra (i)** | | **12,740,849** | **13,673,027** |
| **Total Detyrime** | | **12,740,849** | **13,673,027** |
| | | | |
| **ii. Kapitali dhe Rezervat** | | | |
| Fitime të mbartura | | 1,316,000 | 615,022 |
| Fitimi i periudhës | 6 | 1,271,012 | 700,978 |
| **Total kapitali (ii)** | | **2,587,012** | **1,316,000** |
| **TOTAL DETYRIME DHE KAPITALI (i+ii)** | | **15,327,861** | **14,989,027** |

Andi Haxhillari
**Andi Haxhillari**
Kontabilist

AlProfit Consult
Andi Haxhillari • L72008007D
Konsulencë Financiare

Albert Kolaj
**Albert Kolaj**
Person fizik

# Albert Kolaj Person fizik

## Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare
## për vitin që mbyllet në datë 31.Dhjetor.2017

| | Shënime | Për vitin e mbyllur në 31.Dhjetor.2017 (Lekë) | Për vitin e mbyllur në 31.Dhjetor.2016 (Lekë) |
|---|---|---|---|
| **i. Fluksi monetar përdorur nga veprimtaritë e shfrytëzimit** | | | |
| Të arkëtuara nga të drejtat e arkëtueshme | 3,8 | 9,152,504 | 2,506,678 |
| Të paguara për llogaritë e pagueshme | 9,4,5,9,13 | -7,491,092 | -3,107,754 |
| Interesi i paguar | | -204 | -11,384 |
| Tatimfitimi i paguar | 6 | -238,611 | -51,563 |
| **Rrjedha e parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit (i)** | | **1,422,597** | **-664,023** |
| **ii. Fluksi monetar përdorur për veprimtaritë investuese** | | | |
| Blerja e aktiveve afatgjata materiale | 10 | -532,890 | -132,463 |
| **Paraja e përdorur në aktivitetet e investimit (ii)** | | **-532,890** | **-132,463** |
| **iii. Fluksi monetar nga aktivitetet financiare** | | | |
| Marrje hua | 11 | -1,130,000 | 910,000 |
| **Rrjedha e parasë nga aktivitetet e financimit (iii)** | | **-1,130,000** | **910,000** |
| **Rënia neto e mjeteve monetare (i + ii + iii)** | | **-240,293** | **113,514** |
| Mjetet monetare në fillim të periudhës | | 312,035 | 198,522 |
| Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare | | 0 | 0 |
| **Mjetet monetare në fund të periudhës** | | **71,741** | **312,035** |

Andi Haxhillari
**Andi Haxhillari**
Kontabilist

AlProfit Consult
Andi Haxhillari • L72008007D
Konsulencë Financiare

Albert Kolaj
**Albert Kolaj**
Person fizik

Shërbime Elektrike
ALBERT KOLAJ
TIRANË ALBANIA

## Politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare

(Të gjitha shumat në Lekë, përveç nëse është cilësuar ndryshe)

### 1. Informacion i përgjithshëm

Albert Kolaj, person fizik, është regjistruar në datë 01.10.2005, me numër unik K52207007B. Ai zhvillon aktivitetin në fushën e shërbimeve dhe punimeve elektrike, në rrethin e Tiranës, me seli në adresën Tiranë, Kashar, Unaza e Re, Pallati i firmës "Vila L", 70 m nga Astiri.

Veprimtaria e tij rregullohet sipas dispozitave përkatëse te Ligjit 9901 date 14.04.2008, *"Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare"* dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi.

### 2. Baza e përgatitjes dhe politikat kontabël

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me *Standartet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri (SKK)* të publikuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. Në rastet kur SKK nuk parashikojnë çështje të veçanta, janë zbatuar parashikimet në *Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme.* Pasqyrat financiare janë përgatitur në Lekë Shqiptare.

2.1. Bazat e matjeve

Në përgatitjen e pasqyrave financiare janë zbatuar parimet kontabël që njihen si më të përshtatshme për të matur dhe paraqitur gjendjen financiare, rezultatin financiar dhe flukset e parasë mbi gjendjen e kontabilitetit rrjedhës (të drejtat dhe detyrimet e konstatuara).

2.2. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shitja e punimeve dhe shërbimeve ndërtimore njihen në momentin e dorëzimit dhe transferimit të drejtës ligjore. Si të ardhurat ashtu edhe shpenzimet e njësisë ekonomike raportuese kontabilizohen sipas metodës së konstatimit të drejtave dhe detyrimeve. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, neto nga skontimet dhe taksat përkatëse të shitjes.

2.3. Veprimet në monedhë të huaj

Veprimet në monedha të huaja janë përkthyer në Lekë Shqiptare me kursin në datën e transaksionit. Të drejtat dhe detyrimet në monedhë të huaj janë paraqitur në pasqyrat financiare në Lekë Shqiptare (ALL) të përkthyera me kursin në datën e pasqyrave financiare. Diferencat e rezultuara nga përkthimi janë njohur në pasqyrën e rezultatit. Kurset e këmbimit më te rëndësishme të përdorura janë.

| Monedha | 31.Dhjetor 2017 | 31.Dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| EUR | 132.95 | 135.23 |

2.4. Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Shumica e shitjeve bëhen në bazë të afateve normale të kredisë, dhe llogaritë e arkëtueshme nuk mbartin interes. Në fund të çdo periudhe raportimi, vlerat kontabël të llogarive të arkëtueshme tregtare dhe llogarive të tjera të arkëtueshme rishikohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive që tregon se shumat nuk janë të rikuperueshme. Nëse është kështu, njihet menjëherë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.

2.5. Inventari

Inventari përbëhet nga materiale që do të përdoren për ofrimin e punimeve dhe shërbimeve. Inventarët paraqiten me më të ultën e kostos dhe çmimit të shitjes minus kostot e përfundimit dhe të shitjes. Kosto llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.



AlProfit Consult
Andi Haxhillari • L72008007
Konsulencë Financiare

Shërbime Elektrik
ALBERT KOLAJ
TIRANE ALBANIA

**2. Baza e përgatitjes dhe politikat kontabël (vazhdim)**

2.6. Aktivet materiale

Aktivet Afatgjata materiale paraqiten në bilanc me vlerën e tyre neto. Vlera e AAM është paraqitur ne Bilanc me koston e pakësuar me amortizimin e akumuluar të këtyre aktiveve. Amortizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale është llogaritur me normat që përcaktohen në SKK 5. Normat e amortizimit janë përdorur ato norma të aprovuara nga vendimmarrja, brenda normave që përcakton legjislacioni fiskal ne fuqi si më poshtë:

| | |
|---|---|
| Makineri, Pajisje | 20% |
| Informatike | 25% |
| Mjete transporti | 20% |
| Të tjera | 20% |

2.7. Titujt e huamarrjes

Shpenzimet e interesit njihen në bazë të metodës së interesit efektiv dhe përfshihen në shpenzimet financiare.

2.8. Llogaritë e pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime në bazë të afateve normale të kredisë dhe nuk mbartin interes. Llogaritë e pagueshme tregtare të shprehura në një monedhë të huaj përkthehen në Lekë duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit.

2.9. Tatimi mbi të ardhurat

Shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat paraqet shumën e tatimit aktualisht të pagueshëm. Tatimi aktualisht i pagueshëm bazohet në fitimin e tatueshëm për vitin.

**3. Shitje punime e shërbime**

Në këtë post paraqiten të ardhurat nga kryerja e shërbimeve ndërtimore për vitin 2017, për shumën 10,062,730 Lekë (2016: 3,682,326 Lekë). Të ardhurat janë njohur në momentin e faturimit, pavarësisht arkëtimit të tyre.

**4. Shpenzime të personelit**

| | **Për vitin e mbyllur në 31.Dhjetor.2017** | **Për vitin e mbyllur në 31.Dhjetor.2016** |
|---|---|---|
| Pagat dhe shpërblimet e personelit | 958,448 | 913,205 |
| Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore | 243,510 | 230,926 |
| | **1,201,958** | **1,144,131** |

Numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës raportuese është 5 (2016: 4 punonjës). Në mbyllje të pasqyrave financiare detyrimi për punonjësit e shoqërisë është 494,178 Lekë (2016: 509,683 Lekë)



AlProfit Consult
Andi Haxhillari • L72008007D
Konsulencë Financiare

Shërbime Elektrike
ALBERT KOLAJ
TIRANË ALBANIA

## 5. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Në këtë post paraqiten shpenzime të tjera qe janë realizuar ne funksion te aktivitetit kryesor të detajuara si vijon.

| | Për vitin e mbyllur në 31.Dhjetor.2017 | Për vitin e mbyllur në 31.Dhjetor.2016 |
|---|---|---|
| Mirëmbajtje dhe riparime | 65,017 | 4,999 |
| Personel jashtë njësisë | 28,000 | 0 |
| Shpenzime për shërbimet bankare | 10,398 | 13,785 |
| Taksa dhe tarifa vendore | 70,520 | 68,760 |
| Gjoba dhe penalitete | 0 | 9,344 |
| | **173,934** | **96,888** |

## 6. Fitimi neto i periudhës

Më poshtë tregohet analiza e fitimit të realizuar gjatë periudhës raportuese.

| | Për vitin e mbyllur në 31.Dhjetor.2017 | Për vitin e mbyllur në 31.Dhjetor.2016 |
|---|---|---|
| Fitimi para tatimit | 1,509,623 | 752,541 |
| Shpenzime të pazbritshme (6.1) | 81,116 | 9,344 |
| **Rezultati tatimor** | **1,590,739** | **761,885** |
| Humbje e mbartur | 0 | 418,131 |
| Baza e llogaritjes së tatimit | **1,590,739** | **343,754** |
| % e tatim Fitimit | 15% | 15% |
| Tatim Fitimi | 238,611 | 51,563 |
| **Fitimi neto i periudhës** | **1,271,012** | **700,978** |

6.1. Shpenzime të pazbritshme

Në shpenzimet e pazbritshme për qëllime të llogaritjes së tatimit mbi fitimin janë përfshirë shpenzimet për paga të punonjësve të paguara cash 81,116 Lekë, sipas parashikimeve të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "*Për Tatimin mbi Të ardhurat*", i ndryshuar.

| | Për vitin e mbyllur në 31.Dhjetor.2017 | Për vitin e mbyllur në 31.Dhjetor.2016 |
|---|---|---|
| Gjoba dhe penalitete | 0 | 9,344 |
| Paga të paguara Cash | 81,116 | 0 |
| | **81,116** | **9,344** |



AlProfit Consult
Andi Haxhillari • L72008007S
Konsulencë Financiare

Shërbime Elektrike
ALBERT KOLAJ
TIRANË ALBANIA

## 7. Mjetet monetare

Këtu përfshihet gjendja e mjeteve monetare në arkë dhe në banka. Një analizë e detajuar e gjendjes së likuiditeteve jepet në pasqyrën më poshtë.

| | Në datë 31.Dhjetor.2017 | Në datë 31.Dhjetor.2016 |
|---|---|---|
| Në arkë | 65,709 | 5,583 |
| | **65,709** | **5,583** |
| ProCredit Bank | 1,159 | 832 |
| Banka Kombëtare Tregtare | 4,873 | 305,619 |
| | **6,032** | **306,451** |
| | 71,741 | 312,035 |

## 8. Llogari të arkëtueshme

Në këtë zë të bilancit përfshihen të gjitha të drejtat afatshkurtra të njësisë ndaj të tretëve, të cilat kanë rrjedhur nga veprimet tregtare për kryerjen e shërbimeve në shumën 14,161,874 Lekë (2016: 6,451,648 Lekë).

| | Në datë 31.Dhjetor.2017 | Në datë 31.Dhjetor.2016 |
|---|---|---|
| Navs shpk | 8,400,000 | 8,400,000 |
| Vila L shpk | 2,420,000 | 2,420,000 |
| Rafaelo 2002 sha | 1,736,000 | 1,256,000 |
| KAEXH shpk | 1,039,161 | 0 |
| Tete Albania Tunnel & Mining shpk | 300,000 | 0 |
| Muka shpk | 242,000 | 362,000 |
| Eurosistem Albania shpk | 24,713 | 813,648 |
| | **14,161,874** | **13,251,648** |

Nuk janë njohur zhvlerësime në llogaritë e arkëtueshme sepse vlerësohet që kjo shumë do të arkëtohet plotësisht.

## 9. Inventarët

Paraqitja e gjendja e lendeve të para me vlerë 94,673 Lekë që do të përdoren në funksion të furnizimit të shërbimeve ndërtimore (2016: 595,388 Lekë).

Gjatë periudhës kontabël është njohur si shpenzim për lëndë të para shuma prej 7,003,001Lekë, të përdorura në për furnizimin e shërbimeve ndërtimore (2016: 1,532,263 Lekë).



AlProfit Consult
Andi Haxhillari • L72008007D
Konsulencë Financiare

Shërbime Elektrik
ALBERT KOLAJ
TIRANË ALBANIA

## 10. Aktive materiale

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive materiale afatgjata sipas SKK 5.

| | Makineri dhe pajisje | Mjete transporti | Zyre dhe informatike | Totali |
|---|---|---|---|---|
| **Kosto** | | | | |
| 01 Janar 2016 | 1,625,538 | - | 330,834 | 1,956,372 |
| Shtesa nga blerjet | 132,466 | - | - | 132,466 |
| Jashtë përdorimit | -19,271 | - | -25,000 | - 44,271 |
| **31 Dhjetor 2016** | **1,738,733** | **-** | **305,834** | **2,044,567** |
| Shtesa nga blerjet | 122,000 | 212,640 | 198,250 | 532,890 |
| **31 Dhjetor 2017** | **1,860,733** | **212,640** | **504,084** | **2,577,457** |
| **Amortizimi** | | | | |
| 01 Janar 2016 | 1,065,853 | - | 237,172 | 1,303,025 |
| Shtesa e llogaritur | 121,706 | - | 23,416 | 145,121 |
| Jashtë përdorimit | - 19,271 | - | - 25,000 | - 44,271 |
| **31 Dhjetor 2016** | **1,168,288** | **-** | **235,587** | **1,403,875** |
| Shtesa e llogaritur | 131,889 | 7,088 | 35,035 | 174,012 |
| **31 Dhjetor 2017** | **1,300,177** | **7,088** | **270,622** | **1,577,887** |
| **Vlera neto** | | | | |
| 01 Janar 2016 | 559,685 | - | 93,662 | 653,347 |
| 31 Dhjetor 2016 | 570,445 | - | 70,247 | 640,692 |
| **31 Dhjetor 2017** | **560,556** | **205,552** | **233,462** | **999,573** |

Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi i akumuluar. Të gjitha aktivet afatgjata materiale janë përfituar nga blerjet. Inventari i aktiveve afatgjatë materiale është vlerësuar me koston e marrjes se tyre.

## 11. Titujt e huamarrjes

Paraqiten huamarrjet prej 11,097,779 lekë për financime të aktivitetit afatshkurtër, të mbartur nga periudhat e kaluara. Kjo hua trajtohet pa interes dhe pritet që të shlyhet gjatë vitit 2018. Gjatë periudhës raportuese është paguar pjesërisht shuma 1,130,000 Lekë.

## 12. Llogari të pagueshme

Në këtë grup përfshihen të gjitha llogaritë që paraqesin detyrimet tregtare të njësisë ekonomike ndaj të tretëve për mallrat dhe shërbimet e blera e të papaguara.

| | Në datë 31.Dhjetor.2017 | Në datë 31.Dhjetor.2016 |
|---|---|---|
| Fredi A shpk | 599,520 | 599,520 |
| A Bi Esse shpk | 157,494 | 0 |
| Electric System Albania shpk | 128,520 | 128,520 |
| Olt Da shpk | 64,902 | 64,902 |
| Andi Haxhillari | 8,400 | 0 |
| | **958,836** | **792,942** |



AlProfit Consult
Andi Haxhillari • L72008007D
Konsulencë Financiare

Shërbime Elektrike ALBERT KOLAJ TIRANË ALBANIA

## 13. Detyrime tatimore

Në këtë zë përfshihen të gjitha detyrimet e njësisë ekonomike për të gjitha llojet e tatimeve dhe taksave të llogaritura e të papaguara ndaj shtetit të detajuara si më poshtë, të cilat do të shlyhen brenda 12 muajve nga data e ndërtimit të Pasqyrave Financiare.

| | Në datë 31.Dhjetor.2017 | Në datë 31.Dhjetor.2016 |
|---|---|---|
| Sigurime shoqërore dhe shëndetësore | 27,416 | 31,691 |
| Tatimi mbi vlerën e shtuar | 113,293 | 110,932 |
| Tatimi mbi fitimin (a) | 49,347 | 0 |
| | **190,056** | **142,623** |

13.1. Tatimi mbi fitimin

Më poshtë paraqitet llogaritja e detyrimit për tatimin mbi fitimin e periudhës (shiko edhe shënimin 6).

| | Në datë 31.Dhjetor.2017 | Në datë 31.Dhjetor.2016 |
|---|---|---|
| Tatim Fitimi (shënimi 6) | 238,611 | 51,563 |
| Gjendja e mbartur (kreditore) | 189,264 | 240,827 |
| **Detyrimi (kredia)** | **49,347** | **-189,264** |

## 14. Miratimi i pasqyrave financiare

Këto pasqyra janë miratuar nga organi ekzekutiv, dhe janë autorizuar për t'u publikuar më 31.Janar.2018.

AlProfit Consult
Andi Haxhillari • L72008007D
Konsulencë Financiare

Shërbime Elektrik
ALBERT KOLAJ
TIRANË ALBANIA